



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT
DEKANATI

Nr. ____ prot.

Tiranë më, ____ . ____ . 2024

Lënda: Propozimi i kriterëve për pranimin e studentëve në programin 2 vjeçar Profesional, ciklin e parë të studimeve Bachelor dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave & Master Profesional, **për vitin akademik 2025-2026.**

REKTORATIT TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Për dijeni: ZËVËNDËS REKTORIT PËR MËSIMIN

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në shkresën e MAS me Nr. 7711 Prot., datë 13.12.2023 për ”Publikimin e Kriterëve të Pranimit të Studentëve për Vitin Akademik 2025-2026”, si dhe në propozimet e Departamenteve, Dekanati në mbledhjen e tij të datës 07.02.2024 propozon si më poshtë:

A. Kriteret e Pranimit në Programin Profesional 2 vjeçar

1. Në programet e studimit 2 vjeçare Profesionale në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit pranohen kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë përfunduar jo më pak se 12 vite shkollë në ciklet parauniversitar. Gjithashtu në këto programe studimi pranohen edhe ata kandidatë që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar prej tyre në vendin e huaj nga MAS. Për të aplikuar në këto programe nuk ka kufi të poshtëm për mesataren e shkollës së mesme.
2. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programet e studimit 2 vjeçare Profesionale do të kryhet bazuar **notës mesatare sipas VKM-së.**

B. Kriteret e Pranimit në Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor

1. Në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit pranohen kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë përfunduar jo më pak se 12 vite shkollë në ciklet parauniversitar. Gjithashtu në këto programe studimi pranohen edhe

ata kandidatë që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar prej tyre në vendin e huaj nga MAS.

2. Pranimit në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm, si më sipër, dhe që plotëson:
 - **Kriterin e meritës** (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - **Kriterin e rëndësisë** (koeficienti i përcaktuar për shkollën e mesme nga vjen sipas përcaktimeve të vendosura nga FEA, shiko Aneks 1).
 - **Notës mesatare të lëndës me zgjedhje në fushën e ekonomisë.**
 - **Kuotave të paracaktuara nga FEA.**
3. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në ciklin e parë të studimeve (**Bachelor**) do të jetë rezultat i produktit: **nota mesatare sipas VKM * 0.9* koeficienti rëndësisë** (koeficienti i përcaktuar për shkollën e mesme nga vjen sipas përcaktimeve të vendosura nga FEA) + **notë mesatare e lëndës me zgjedhje në fushën e ekonomisë *0.1.**

C. Kriteret e Pranimit në Ciklin e Dytë të Studimeve Master i Shkencave

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën "**Master i Shkencave**" individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare "**Bachelor**" ose **diplome e "Integruar"** në sistemin me kohë të plotë ose të pjesëshme, si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë vijojnë:
 - a. **Kriterin e meritës.** Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë (bachelor) në profilet e ekonomisë, **të jetë 7.0 e lart.** Në rast se ka ende kuota të lira, kufiri i poshtëm për mesataren e ciklit të parë bachelor do të vendoset me vendim Dekanati.
 - b. **Kriterin e rëndësisë.** Koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të FEA_s janë si më poshtë:
 - Kandidatët e diplomuar në ekonomi në UBT, në të njëjtin profil/program studimi që është bërë aplikimi, **koeficienti 1.00.**
 - Kandidatët e diplomuar në ekonomi jashtë UBT-s, në të njëjtin profil/program studimi që është bërë aplikimi, **koeficienti 0.9.**
 - Kandidatet e diplomuar në ekonomi në brenda ose jashtë UBT, jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, **koeficienti 0.75.**
 - Kandidatet e diplomuar ne fusha te tjera jo ekonomike brenda ose jashtë UBT-s, **koeficienti 0.7.**
 - c. **Kuotave të paracaktuara nga FEA.**
2. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin "**Master i Shkencave**" do të jetë rezultat i produktit: **notë mesatare e ponderuar në bachelor * koeficient** (sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet); duke gjeneruar kështu një listë

vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste **brenda kuotave** të paracaktuara nga FEA për çdo program studimi.

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë ”**Master i Shkencave**” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht). Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë përgjegjëse të Arsimit të Lartë, si dhe me Vendim Senati Akademik të UBT-s.
4. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve **Master i Shkencave** kandidatët që kanë përfunduar një program të ciklit të dytë (**Master Profesional ose Master Shkencor**). Këta individë aplikojnë për kuotat e veçanta për program të dytë studimi.
5. Në programin e studimit ”**Master i Shkencave**” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë, ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UBT-s, në Rregulloren e Fakultetit si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit.

D. Kriteret e Pranimi në Ciklin e Dytë të Studimeve Master Profesional

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën “**Master Profesional**” individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “**Bachelor**” ose diplomë e “**Integruar**”, në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë vijojnë:
 - a. **Kriterin e meritës.** Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë bachelor.
 - b. **Kriterin e rëndësisë.** Koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të FEA_s janë si më poshtë:
 - Kandidatët e diplomuar në ekonomi në UBT dhe jashtë UBT-s , **në të njëjtin profil/program studimi** që është bërë aplikimi, **koeficienti 1.00.**
 - Kandidatët e diplomuar në ekonomi në UBT, **jashtë profileve/ programeve të studimit** që është bërë aplikimi, **koeficienti 0.85.**
 - Kandidatët e diplomuar në ekonomi jashtë UBT-s, **jashtë profileve të studimit** që është bërë aplikimi, **koeficienti 0.8.**
 - Kandidatët e diplomuar në UBT/jashtë UBT-së, në profile studimi **jashtë fushës së ekonomisë**, **koeficienti 0.75.**
 - c. **Kuotave të paracaktuara nga FEA.**
2. Përzgjedhja e kandidatëve fitues ne programin “**Master Profesional**” do të jetë rezultat i produktit: **notë mesatare te ponderuar në bachelor * koeficient** (sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet); duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj listë **brenda kuotave** të

paracaktuara nga FEA për çdo program studimi.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve **Master Profesional** kandidatët që kanë përfunduar një program të ciklit të dytë (**Master Profesional ose Master Shkencor**). Këta individë aplikojnë për kuotat e vecanta për program të dytë studimi.
4. Në programin e studimit "**Master Profesional**" në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë, ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UBT-s, në Rregulloren e Fakultetit si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit.

DEKANI
Prof. Dr. Remzi Keco

Aneks 1

Index Profili	Emertimi i Profilit	Koef.
0	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	0.7
1	GJIMNAZ	1
2	GJIMNAZ ME KOHË TË SHKURTUAR	0.85
3	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-FRENGJISHT	0.95
4	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-ITALISHT	0.95
5	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT	0.95
6	GJIMNAZ GJUHËSOR	0.95
7	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	0.7
8	SHKOLLË SPORTIVE	0.7
9	SHKOLLË PEDAGOGJIKE	0.7
10	HOTELERI-TURIZËM	0.95
11	SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI	0.8
12	MEKANIKË	0.8
13	ELEKTROTEKNIKË	0.8
14	ELEKTRONIKË	0.8
15	PËRPUNIM DRURI	0.8
16	NDËRTIM	0.8
17	TEKSTIL-KONFEKSIONE	0.8
18	TEKNOLOGJI USHQIMORE	0.8
19	BUJQËSI	0.9
20	SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE	0.7
21	VETERINARI	0.7
22	GJEODEZI	0.8
23	INSTALUES I SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE	0.8
24	LLOGARI	0.9
25	SHËRBIME BANKARE	1
26	ADMINISTRIM BIZNESI	1
27	RRJETE TË DHËNASH	0.95
28	MBËSHTETJE E PËRDORUESVE TË TIK	0.95
29	TEKNOLOGJI KIMIKE	0.7
30	SIPËRMARRJE E AGJENCISË TURISTIKE	0.95
31	AGROBIZNES	1
32	ZHVILLIM ËEBSITE	0.95
33	SIGURIME	0.9
34	SILVIKULTURË	0.7
35	HARRY FULTZ, BIZNES	1
36	HARRY FULTZ, ELEKTRONIKË	0.9
37	HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK	0.8
38	PETER MAHRINGER, TEKNOLOGJI INFORMACIONI	0.8

39	PESHKIM	0.7
40	GJELOGJI-MINIERA	0.7
41	TREGTI	1
42	RRJETE TË DHËNASH (PILOT-GIZ)	0.95
43	INXHINIERI INFORMATIKE SOFTËARESH (HERMANN GMEINER)	0.7
44	TEKSTIL-KONFEKSIONE(NABER ADA)	0.7
45	DETARI	0.7
46	PROFILI IM NUK ËSHTË NË LISTË	0.7
47	SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT FAIK KONICA	0.95
49	SHKOLLË SPORTIVE	0.7
50	KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM NAFTE, GAZI DHE UJI	0.7
51	SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR (PILOT – GIZ)	0.7
97	PETER MAHRINGER, TEKNOLOGJI INFORMACIONI	0.95
98	ELEKTRONIKË NË TEKNOLOGJINË E AUTOMATIZIMIT	0.9
99	VJEN NGA JASHTË SHTETIT	0.85
100	GJIMNAZ - f1	0.7
101	GJIMNAZ - f2	0.7
102	GJIMNAZ - KINGS TIRANA	0.7
103	GJIMNAZ - 2 KURRIKULA	0.7
104	GJIMNAZ - f1 - 2 kurrikula	0.7
105	GJIMNAZ - mix	0.7
106	GJIMNAZ - MIST	0.7
201	GJIMNAZ - 2 KURRIKULA KSH	0.7
601	GJIMNAZ GJUHËSOR - P.S	0.7